



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri  
Mbledhja nr. 37  
Prishtinë, më 16 Dhjetor 2009  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225  
Mbledhja filloi në orën 11:00

**P R O C E S V E R B A L**

**I mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri**

**Morën pjesë anëtarët e komisionit:** Rrustem Mustafa, Suzana Novoberdaliu, Melihate Termkollli, Zafir Berisha, Shkumbin Demaliaj, Lulzim Zeneli.

**Munguan:** Zylfi Merxha, Eqrem Kryeziu dhe Bojan Stojanovič.

**Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë:** Nur Çeku, Nuredin Ibishi, Blerina Pula dhe Fatbardha Boletini.

**Mbledhjen e kryesoi:** Rrustem Mustafa, kryetari i komisionit.

**Rendi i ditës**

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të datës **25.11.2009**
3. Shqyrtimi i situatës aktuale të sigurisë
4. Të ndryshme

*Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.*

## **2. Miratimi i procesverbalit të datës 25.11.2009**

*Procesverbali i datës 25.11.2009 u miratua pa vërejtje.*

## **3. Shqyrtimi i situatës aktuale të sigurisë**

**Kryetari i Komisionit – tha,** nga mbledhja e kaluar deri më sot ka pasur tendenca për gjendjen e sigurisë të duket sikur nuk është e qetë. Unë konstatoj se në bazë të dhënave zyrtare të shtetit dhe mekanizmave relevant, gjendja e sigurisë në vend është stabile. Ka pas ndërhyrje të mediave në këtë proces, dhe është parë që mediat nuk janë të kontrolluara nga askush. Unë i mbështes deklaratat e krerëve shtetërorë që kanë thënë se drejtësia duhet ta bëjë punën e vet, pa ndërhyrje nga askush. Sa i përket ndërtimit të një vendqëndrimi të forcave serbe në Bujanovc, më vjen mirë që kam dëgjuar insistime nga kreu i NATO-s në Kosovë, se siguria në vendin tonë nuk po cenohet.

**Shkumbin Demaliaj –** Konsideroj se dy segmentet që u përmendën, si rasti Bllaca dhe ajo i ndërtimit të kazermës ushtarake në Serbi shumë afër kufirit, për mua dhe subjektin tim janë mjaft shqetësuese. Shqetësuese për mua kanë qenë deklaratat e krerëve shtetërorë për këtë çështje që nuk kanë qenë të njëjta dhe kanë deklaruar secili ndaras. Rasti Bllaca nuk ka qenë shqetësuese por ka qenë një alarmim i mekanizmave të sigurisë që duhet ta kryejnë punën e vet.

**Melihate Termkollli –** Unë mendoj se mekanizmi parlamentar nuk duhet ti fajësoj mediat për rastin Bllaca, sepse faji është te mosfunksionimi i institucioneve të drejtësisë. Mediat e kanë bërë punën e vet, sepse vet personi ka dal me deklaratë afër Kuvendit, dhe një deputet i Kuvendit, këtë çështje e ka hap në seancë. E kemi parë deklaratën e gjeneralit të NATO-s, që siguria në Kosovë nuk po cenohet. Pse edhe ne si institucione nuk e shtojmë çështjen për ndërtimin e një kazermë në veri të Kosovës, dhe të shohim se a po cenohet siguria e dikujt. Një çështje që këtu nuk u përmend është deklarimi i Qeverisë për shkëputjen e koalicionit, që për mendimin tim është veprimi më i rrezikshëm, ku është cenuar siguria. Unë kam një propozim në lidhje me këtë çështje, të bëhet një debat, sepse dikush duhet të përgjigjet edhe për atë që ka ndodh.

**Kryetari i Komisionit – tha,** rasti Bllaca kaluar nga komisioni në nivel më të lartë, sepse ju e dini që Këshilli i sigurisë ka mbajtur mbledhje dy herë në lidhje me këtë çështje.

**Zafir Berisha –** Komisioni dhe organet e sigurisë janë përgjegjëse për sigurinë në vend. Mendoj se po cenohet siguria tek kufiri në pjesën veriore dhe me Malin e Zi.

Tani kemi edhe komisionin për FSK-në, mendoj se duhet ta kemi një takim të përbashkët që të nxjerrim një rekomandim, për ndërtimin e një kazerme në pjesën veriore që të rritet siguria e vendit.

**Lulzim Zeneli** – Situata aktuale e sigurisë si pikë e rendit të ditës, ka të bëjë me ngjarjet e fundit që kanë ndodhur. Ne mund të diskutojmë për këtë çështje, mirëpo secili e ka përcipcionin e vet për situatën e sigurisë. Kjo reflekton në funksionimin e shtyllave kryesore të shtetësisë. Nëse kemi parasysh, se sa janë funksionale shtyllat e shtetësisë së Kosovës, atëherë situata e sigurisë është shumë e brishtë. U përmendën disa çështje, si p.sh ajo e kufirit. A e din Kosova ku i ka kufijtë e saj dhe a i kontrollon ata kufij? A ka agjendë shtetërore ku ndihet dora shtetit në gjithë territorin? Unë mendoj se jo vetëm të ftohet Ministri e Punëve të Brendshme me një raport, por edhe njerëzit më të lartë të shtetit që janë kompetent.

**Shkumbin Demaliaj** – Unë kisha kërkuar nga ju kryetar që sa i përket dhomës së dëshmimeve që mos ta marrësh përgjegjësinë, sepse të gjithë kanë qenë kundër komisionit për siguri dhe qëndrimeve të marra.

**Suzana Novoberdaliu** – Sa i përket dhomës së dëshmimeve, unë pata parashtruar pyetje edhe Ministrit, dhe as pas 7 muajve nuk është ndriçuar asgjë për këtë rast. Unë nuk po mendoj si komision, sepse e kam të drejtën edhe si deputete ta inicioj këtë çështje duke bërë pyetje se ku janë me procedurën e ndriçimit të rastit. Gjatë gjithë kohës ne po flasim, ndërsa tri shtylla të shtetit nuk po funksionojnë si: policia, gjyqësia dhe prokuroria. Nëse themi se gjyqësia e prokuroria janë të pavarura, ndërsa ato nuk po funksionojnë. Tani shtrohet pyetja a po keqpërdorët kjo pavarësi? Ata duhet të përgjigjen për punën e tyre të cilën nuk e kryejnë.

## 5. Të ndryshme

**Kryetari i Komisionit** – **tha**, kemi qenë në një vizitë dy ditore në Shqipëri, ku kemi marr pjesë nga komisioni dhe nga Kryesia e Kuvendit. Gjatë konferencës është ratifikuar një marrëveshje për siguri e shteteve të Evropës Juglindore. Shteti jonë e ka mbështetur këtë iniciativë dhe mbetet të shohim se si do të procedohet më tutje.

Kemi një njoftim nga Suzana Novoberdaliu për Projektligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

**Suzana Novoberdaliu** – Ne kemi mbajtur një dëgjim publik për këtë projektligj ku kanë marr pjesë përfaqësues nga MPB-ja, si sponsorues të këtij projektligji. Ligji është mjaft i mirë, duke pasur parasysh që përfaqësuesit e MPB-së, na bënë të ditur se një ekspert gjerman ka dhënë kontribut në hartimin e projektligjit. Unë kam kërkuar nga ata ti dërgojnë edhe me shkrim propozimet që i kanë, në mënyrë që të përfshihen në këtë projektligj.

**Kryetari i Komisionit** – **tha**, kjo duhet të kryhet sa më shpejtë në mënyrë që të jemi në kohë, sepse komisioni për siguri nuk është vonuar kurrë në shqyrtimin e ligjeve.

Pasi që nuk kishte pika tjera për të diskutuar, kryetari i komisionit e mbylli këtë takim.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

Përgatiti:  
Njësia Mbështetëse e Komisionit

Kryetar i Komisionit  
Rrustem Mustafa